PËRSHPEJTIM I ZHVILLIMIT DHE BASHKËPUNIMIT QYTETAR

Përmirësimi i politikave lokale të qeverisjes, nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve

Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane
TIRANË, 2019

INSTITUTI I STUDIMEVE SOCIALE DHE HUMANE

USAID NGA POPULLI AMERIKAN

Autorë: Artan Sadiku, Leart Kola, Joleza Koka, Greta Llambro

Përpunimi grafik: Joleza Koka

Përkrahur nga: USAID

Publikuar sipas CC – Creative Commons

PËRMBAJTJA

Përmbajtja
Parathënie

I. HYRJE
1. Hyrje
2. Qëllimi i hulumtimit
3. Metodologjia
4. Përmbledhje e përgjithshme
II. ANALIZË
5. Analiza e gjetjeve nga anketimi
5.1 Tiranë
5.2 Sarandë
5.3 Lezhë
5.4 Peshkopi
5.5 Korçë
III. PËRFUNDIME
6. Përfundimet nga fokus grupet, intervistat dhe forumet
6.1 Tiranë
6.2 Sarandë
6.3 Lezhë
6.4 Peshkopi
6.5 Korçë
7. Përfundime mbi programin e transparencës
IV. Rekomandime
Rekomandime
Rreth ISSH

PARATHENIE

Realizimi i këtij studimi ka ardhur fal angazhimit të një numri të madh pjesëmarrësish, përgjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore, të cilët dëshirojmë ti falenderojmë.

Në krye te herës, në emrër të Institutit të Studimeve Sociale dhe Humane do doja të evidentoja, ndihmën e USAID, pa të cilën nuk do të bëhej i mundur realizimi i këtij studimi. Në veçanti skuadrën e Albanian National Training and Technical Assistance Resource Centre (ANTTARC) Myftar Doçi, Natasha Mazari dhe Jerina Stamo, të cilët nuk u kufizuan vetëm në këshillimin teknik dhe në ruajtjen e kornizave të realizmit të projektit, por na ndihmuan dhe me këshilla shumë të vlefshme nga eksperienca e tyre shumëvjecare me punën me shoqerinë civile në Shqipëri.

Kemi qenë me fat, që në terren na kanë ndihmuar koordinatorë në të pesë Bashkitë, të cilat u morën për kampion në këtë studim. Iu jemi shumë mirënjohës për punën e tyre; Miladin Fili në Korçë, i cili ishte një organizator i jashtëzakonshëm e na ndihmoi jo vetëm me punën në terren, por dhe me organizmin e të dhënave nga individë dhe institucione lokale. Keler Sufja në Lezhë, puna e të cilit me Shërbimin Social Shtetëror, ishte një minierë informacioni, për të testuar ndryshimet, që ka sjellë reforma territoriale sidomos në shërbimet, që duhet ti jepen grupeve më vulnerabël në atë zonë. Saranda na dha një mundësi gjatë udhëtimeve tona të shpeshta në zonë, për të provuar dhe angazhimin, që shumë shtetas të huaj të cilët ishin rezidentë të përkoheshëm në qytetin e Sarandës, disa prej tyre janë pjesë të intervistavë të zhvilluara në atë qytet dhe shërbyen po ashtu dhe si një eksperiencë interesante për shumë prej sfidave, që vendet e tyre rezidente i kanë kaluar përpara nesh. Ky studim nuk do ishte i plotë dhe pa një qytet me karakteristikat e Sarandës, i cili ka një ndryshim të madh në numër banorësh dhe nevojash për shërbime në stinë të ndryshme të vitit.

Fikret Koçi-t në Peshkopi, dua ti them shumë faleminderit, jo vetëm për shpejtësinë dhe cilësinë në punë, por edhe sepse në ato ditë kur kryheshin intervistimet dhe puna në terren në atë qytet ishin kushte shumë të vështira meteorologjike. Shpesh herë kemi udhëtuar në komuna të tjera në një borë të jashtëzakonshme. E në fund, por jo e fundit koordinatoren, që kishim në Tiranë Greta Llambro-n, e cila jo vetëm u kujdes, që të merrte pjesë personalisht në qindra intervista të bera në qytetin e Tiranës, por shërbeu dhe si koordinatore në zyren qendrore për të gjithë koordinatorët tanë në bashkitë e tjera. Serioziteti me të cilin ajo punoi ishte nje kusht i domosdoshëm dhe për të saktësinë sidomos në materialet të cilët shërbyen si bazë për ekspertët tanë për të konceptuar këtë studim dhe mbi të gjtiha për të listuar sygjerimet, që ne mendojmë se duhet të merren parasysh në fazat e ndryshme kur do të behen rishikime në reformën territoriale.

I jam shumë mirënjohës BASHKISE TIRANE dhe posaçërisht nën-kryetarit Arbjan Mazniku, që shërbeu jo vetëm si këshilltar por dhe si frymezues i disa prej sygjerimeve, që do gjeni në këtë studim. Ministria e Brendshme, si institucion përgjegjës për pushtetin lokal dhe institucion garantues në zbatimin e reformës territoriale, na ndihmoi me ekspertizën shumë të vyer të këshilltarëve Aida Gjika dhe Bekim Murati me drejtimin politik të pakursyer të zv.Ministres Romina Kuko.

Gjatë këtij rrugëtimi, ndalesa të rëndësishme ishin dhe konsultimet me Adelina Farrici-n, drejtuesen e Shoqatës së Autonomisë Vendore, e cila dhe nëpërmjet eksperiencës së saj si drejtuese e bashkisë së Burrelit i dha këtij studimi dhe një dimension me të madh se sa thjesht atyre bashkive, të cilat kishim marrë për kampionim. Aldrin Dalipi, Kryetari i Qarkut të Tiranës nuk u kursye jo vetëm në kohë, por dhe në hapesirë duke vënë në dispozicion hapësirat e zyrave të qarkut për shumë takime, të cilat ishin të domosdoshme për të farkëtuar sa më mirë idetë e gjithësecilit të përfshirë në këtë projekt. Na pëlqen të mendojmë, që ashtu si ai shërbeu si organizator i institucioneve në Lezhë në ndihmë të projektit dhe ky projekt të ketë shërbyer si frymëzim për Ermal Paca-jn, që kur e nisëm këtë projekt ishte Drejtor i portit të Shëngjinit dhe sot mban postin e nën-kryetarit të Bashkisë Lezhë, faleminderit Ermal dhe urime.

Bashkia Korçë e posaçërisht Kletion Kita, Instituti i Statistikave dhe Drejtoria Arsimore në Korçë ishin vetëm disa prej institucioneve në atë qytet, që u përfshinë jo vetëm me prezencën e tyre në takime por ishin shumë aktiv në mendime dhe ide se si mund ta bënim punën tonë më mirë. Faleminderit Bashkisë Sarandë, stafi i së cilës edhe pse nën presionin e kohës na kushtoi një vëmendje të vecantë, për të cilën jemi shumë mirënjohës.

Në çdo punë të këtij kalibri e me këtë përgjegjësi, janë gjithmonë disa njerëz, që shërbejnë si kritikë të pamëshirshëm. Joleza Koka, ishte një kritike e vendosur por e drejtë jo vetëm në korrektimin e formës dhe prezantimit të studimit por mbi të gjitha të përmbajtjes së tij. Eksperienca në dy mandate si anëtare e Këshillit Bashkiak në Tiranë dhe përfaqësuese e shumë strukturave ndërkombëtare i dha gjetjeve të këtij studimi një perspektivë institucionale të plotë. Joleza shërbeu dhe si supervizore e grupit të dizajnimit gjë për të cilën i jemi shumë mirënjohës.

Në fund, i lënë posaçërisht, pikërisht për rëndësinë që ka, dua të falenderoj Artan Sadikun, njeriun që idenë e ktheu në projekt e projektin e ktheu në studim. Artani, udhëhoqi gjithë grupin dhe punën studimore, të cilën ne jemi shumë krenar ta prezantojmë në këtë botim. Rezidenca e tij në Maqedoni e puna e vazhdueshme në gjithë rajonin na dha mundësinë të "mendonim jashtë kutisë" kur operonim në terren me pyetësorët. Pa të ky projekt do ishte vetëm një "ide kafenesh" e sot nuk do kishim në dorë këtë botim. Për këtë është i domosdoshme një falenderim i madh si për Artanin, por dhe për të gjithë grupin, që e nisem këtë rrugë si individë dhe po e mbyllim si skuadër.

Faleminderit!

Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane

Leart Kola, Drejtor Ekzekutiv

I.
Hyrje

1. Hyrje

Praktika e demokracisë lokale në Shqipëri përpara reformës territoiale si pengesë kryesore ka pasur fragmentim të thellë. Në 373 njësitë e vetadministrimit lokal, që ekzistonin më parë, më së shumti vuanin nga mungesa e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore si dhe nga niveli i ulët i decentralizimit të kompetencave për të ushtruar praktika demokratike në territorin nën administrim.

Qeverisja lokale do të ketë më shumë kompetenca sipas reformës territoriale me punët, që ka në ngarkim, të cilat janë të një rëndësie shumë më të madhe për qytetarët në njësitë e reja administrative. Por, pa një proces të reformuar të bashkëveprimit ndërmjet njësive të reja të qeverisjes lokale dhe qytetarëve, qeverisja lokale do të ndjekë veprimtarinë e trashëguar dhe do ti injorojë nevojat dhe të drejtën demokratike të qytetarëve për të marrë pjesë në vendimarrjen në nivel lokal.

Në krahasim me vendet e tjera në rajon, Shqipëria ka një praktikë më të dobët të demokracisë lokale. Kjo më së shumti është pasojë e zvarritjes së proçesit të decentralizimit dhe si pasojë shpërndarje më të ulët të fondeve dhe resurseve për këto praktika. Krahasimisht, Maqedonia e Veriut dhe Kosova kanë shumë më tepër përvojë dhe tregojnë rezultate më të mira në adresimin e nevojave të qytetarëve në nivel lokal.

Prandaj ky studim ka për qëllim të ofrojë një analizë të kushteve dhe dinamikave në nivel lokal si njohuri themelore rreth krijimit të mekanizmave dhe instrumenteve për pjesëmarrje demokratike në 61 Njësitë e reja të vetqeverisjes lokale. Praktikat e forumeve lokale, forumeve buxhetore dhe forumeve ndër-bashkiake janë treguar si mjaft të suksesshme në shtetet fqinje. Por, para se të transferohen praktika të tilla nga shtetet e tjera ka nevojë, që të realizohet një vlerësim i modaliteteve, diferencave dhe kontekstetve me qëllim, që të dizenjohen modele sa më të suksesshme, që do sjellin indikatorët më të mirë për pjesëmarrje qytetare në nivelin lokal në Shqipëri.

Përzgjedhja e bashkive të Tiranës, Lezhës, Sarandës, Peshkopisë, dhe Korçës ka për qëllim që të mundësojë një pasqyrë më të qartë se si dallimet gjeografike, ekonomike dhe demografike ndikojnë në kushtet për demokracinë lokale dhe pjesëmarrjen qytetare.

Përmbushja e qëllimit për realizimin e demokracisë lokale është një nga aspektet më sensitive dhe delikate të reformës së përgjithshme territoriale. Pa një proçes serioz dhe të hollësishëm të vlerësimit, mundësia për të zhvilluar pjesëmarrje demokratike në nivel lokal mund të përballet me rreziqe që mund të sjellin pasoja serioze lidhur me perceptimin e qytetarëve për përfitimet e tyre nga reforma territoriale.

Prandaj, pa vendosjen e mekanizmave që mundësojnë qasjen e qytetarëve në proçeset e vendimmarrjes lidhur me shërbimet që i trajtojnë nevojat e tyre më të drejtpërdrejta në nivel lokal, qytetarët do të jenë të kufizuar nga përjetimi i përfitimeve të premtuara të reformës.

2. Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim ka për qëllim të analizojë praktikat e qasjes së qytetarëve në vendimmarrjen në nivel lokal nga njëra anë si dhe nevojat e tyre në raport me kapacitetet e administratës lokale. Analiza e përgatitur tenton të përmirësojë politikat e qeverisjes lokale

nëpërmjet pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve, që ti shërbejë më mirë nevojave të qytetarëve, me fokus të veçantë te grupet vulnerabël.

Rezultatet e pritshme të këtij hulumtimi janë:

- Të vlerësojë nevojat, kufizimet dhe kapacitet për ushtrimin e një proçesi përfshirës dhe pjesëmarrës të vendimmarrjes së qytetarëve dhe administratës në nivel lokal;
- Të gjenerojë një model mekanizmash të duhur për praktikat e demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët dhe rritur ndërgjegjësimin e tyre.
- Të gjenerojë proçese bashkëpunuese me faktorët politik në nivel lokal, si dhe transparencë në llogaridhënie nga ana e njësive të qeverisjes vendore.
- Të ndihmojë institucionet shtetërore në zbatimin e objektivave për reformën territoriale.
- Të ndikojë në debatet publike mbi reformën territoriale nëpërmjet argumentëve të politikave të bazuara mbi avancimin e proçeseve të decentralizimit dhe demokratizimit në përputhje me objektivat.

3. Metodologjia

Metodologjia për realizimin e këtij hulumtimi përfshin kombinimin e anketimit, fokus grupeve dhe intervistave individuale në fazë të parë si dhe testimin e metodës së forumeve për prioritetet e politikave në fazë të dytë.



Hulumtimi u realizua në qytetet e Tiranës, Lezhës, Sarëndës, Peshkopisë dhe Korçës, si qytete me karakteristika të ndryshme gjeografike, demografike dhe ekonomike. Gjatë zbatimit të anketimit u përfshinë në total 500 qytetarë nga pesë qytetet e zgjedhura,

ndërsa në fokus grupet morën pjesë gjithsej 60 përfaqësues të shoqërisë civile dhe administratës lokale. Në intervistat individuale morën pjesë 5 përfaqësues që janë të thirrur në përpilimin e politikave nga secila bashki.

Në fazë të dytë u organizuan pesë takime-forume të përbashkëta në mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të bashkive me qëllim që të diskutohen prioritetet e politikave si dhe të testohet modeli i tillë i bashkëpunimit për zhvillimin e demokracisë në nivel lokal. Gjetjet nga këto forume gjithashtu janë analizuar në këtë studim së bashku me prioritetet e diskutuara në fokus grupe dhe intervista individuale.





4. Përmbledhje e përgjithshme

Reforma territoriale si një ligj i përgjithshëm reformues kombëtar nuk duhet të shihet si një projekt përfundimtar, që rezulton në sjelljen e ligjeve sipas supozimeve të saj paraprake. Për shkak të karakterit kompleks të lendës që kjo reformë adreson, hulumtimi ynë tregon se disa aspekte të saj duhet të realizohen duke pilotuar dhe hulumtuar forma dhe modalitete të ndryshme të implementimit të saj. Faza e parë e realizimit të reformës teritoriale duhet të udhëhiqet nga ideja për të dhënë rezultatet sa ma të mira në nivel lokal në aspekt të përmirësimit të shërbimeve si dhe zhvilimit lokal. Për këtë qëllim, ne propozojmë që reforma territoriale duhet të kalojë në fazë rishikimi duke pasur parasysh të dhënat analitike dhe empirike në sferën e shërbimeve dhe zhvillimit lokal. Pas testimit të suksesshëm të modeleve të riorganizimit territorial, tërësia legjislative që shërben për realizimin e reformës duhet të hapet për rishikime dhe përmirësime.

Aspektet kryesore që kjo analizë ka gjetur si mundësi për përmirësimin e efekteve lokale nga implementimi i reformës territoriale kanë të bëjnë me:

- Përforcimin e praktikave lokale nga ana e strukturave civile për të dhënë shembull të suksesit që do të motivojnë qytetarët të besojnë dhe të qasen në praktika të demokracisë lokale;

- Krijimin e formave dhe praktikave të reja institucionale në nivel lokal, forma të cilat risin transparencën e qeverisjes lokale si dhe mundësojnë pjesëmarrjen demokratike në vendimmarje në nivel lokal;

- Koordinimin më të mirë të institucioneve qendrore dhe atyre lokale për politikat që nuk përputhen me logjikën e tanishme të organizimit lokal duke krijuar agjenci dhe fonde që mundësojnë efektivitet më të madh zhvillimor lokal.

II.
Analizë

5. Analiza e gjetjeve nga anketimi

5.1 Tiranë

Anketimi i qytetarëve në bashkinë e Tiranës tregon se qytetarët kanë bindje pozitive lidhur me shërbimet që marrin nga bashkia si edhe në lidhje me përmirësimin e tyre krahasuar me vitet e kaluara. Nga vlerësimi 1-5, 77% e qytetarëve kanë vlerësuar shërbimet e Bashkisë së Tiranës me 4 dhe 5. Gjithashtu një numër i lartë i qytetarëve, rreth 70% konsiderojnë që shërbimet e bashkisë janë përmirësuar në krahasim me vitet e kaluara.Në raport me qasjen e qytetarëve në vendimarrje lidhur me politikat e Bashkisë,



rreth 60% e qytetarëve konsiderojnë që kjo realizohet në mënyrën e duhur dhe e konsiderojnë bashkinë si një institucion i hapur për qytetarët. Ndërsa sa i përket informimit të tyre për punën e bashkisë, 48% thonë që janë pjesërisht të informuar, ndërsa 42% konsiderojnë se kanë informacion të plotë për punën e bashkisë.



Analiza e rezultateve nga anketimi tregon se qytetarët e Tiranës janë të vetëdijshëm për punën e bashkisë si dhe në masë të konsiderueshme besojnë se janë të informuar për punën e saj, mirëpo këto janë gjithësesi parakushte për realizimin e demokracisë lokale, e cila përveç hapjes institucionale kërkon edhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve në vendimmarje.



Në pyetjet lidhur me angazhimin në inisiativa qytetare, vërejmë që ekziston një dozë përmbajtjeje dhe mosbesimi lidhur me suksesin e tyre. 15% besojnë që përmes inisiativave qytetare nuk do të arrijnë asgjë, ndërsa 11% thonë se nuk kanë kohë të merren me këto inisiativa. Rreth 37% e të anketuarve nuk do të merrnin pjesë në një inisiativë qytetare nëse nuk do t'u besonin organizatorëve. Një përqindje kaq e lartë e frikës nga mosbesimi tregon që inisiativat qytetare shpesh mund të jenë të manipuluara dhe mungon një praktikë dhe eksperiencë me shembuj suksesi.



Përderisa OJQ-të janë ato që shpesh iniciojnë inisiativa qytetare, të dhënat e mësipërme konfirmohen edhe në pyetjen lidhur me bindjet e qytetarëve për OJQ-të, ku rreth 40% të tyre besojnë që këto organizata nuk kanë ndonjë kontribut për përmirësimin e politikave dhe shërbimeve lokale.







Demografia e të anketuarve në qytetin e Tiranës.











5.2 Sarandë

Rezultatet e anketimit në Sarandë tregojnë një pakënaqësi të konsiderueshme të qytetarëve në lidhje me pjesëmarrjen qytetare dhe shërbimet që i marrin në nivelin lokal. Rreth 70% e qytetarëve të Sarandës kanë vlerësime negative lidhur me pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në Shqipëri. Me vlerësim të ulët kanë rezultuar edhe shërbimet e bashkisë për qytetarët. 40% e qytetarëve të anketuar i kanë vlerësuar shërbimet e bashkisë me vlerën 2 dhe 40% të tjerë me vlerën 3, përderisa 20% kanë dhënë vlerësimin më të ulët me 1.



Të ngjashme janë edhe vlerësimet lidhur me shërbimet në nivel lokal krahasuar me vitet e kaluara ku 40% e qytetarëve konsiderojnë që ato kanë ngelur të njëjta ndërsa rreth 40% konsiderojnë se shërbimet janë përkeqësuar. Nga këto të dhëna të marra nga anketimi i qytetarëve shohim që në Bashkinë e Sarandës ekziston pakënaqësi lidhur me shërbimet në nivelin lokal dhe kjo lidhet edhe me perceptimin e tyre për atë se sa e hapur është bashkia për qytetarët.



Rezultatet konfirmojnë lidhjen që ekziston mes nivelit të hapjes së bashkisë ndaj qytetarëve dhe kualitetit të shërbimeve që ajo ofron për qytetarët. Prandaj teza që demokracia pjesëmarrëse në nivel lokal rrit kualitetin e shërbimeve është e qëndrueshme dhe verifikohet në rezultatet e anketimit. Rreth 52% e qytetarëve të Sarandës e konsiderojnë bashkinë si një institucion të mbyllur për ta, ndërsa 40% e konsiderojnë atë një institucion pjesërisht të hapur.

Tendencë e ngjashme e vlerësimeve është prezente edhe në pyetjet që kanë të bëjnë më informimin e qytetarëve për punën e bashkisë si dhe vleresimin e realizimit të projekteve të miratuara. Kur qytetarët nuk janë të informuar ata gjithashtu kanë vlerësim negativ për punën e bashkisë. Mosinformimi korrekt dhe transparent i qytetarëve sjell deri tek humbja e besimit tek institucionet lokale me ç'ka vjen edhe deri tek erozioni i legjitimitetit të institucioneve lokale. Rreth 60% e qytetarëve të anketuar në Sarandë thonë që nuk janë të informuar për punën e bashkisë, dhe rreth 80% e tyre vlerësojnë me notën më të ulët realizimin e projekteve të miratuara nga bashkia.



Mungesa e modeleve të pjesëmarrjes si praktikë e demokracisë lokale sjell edhe deri tek humbja e besimit nga ana e qytetarëve për mundësinë e ndryshimit të gjendjes në qytetin e tyre. Kështu, 62% e qytetarëve konsiderojnë që inisiativat qytetare në nivel lokal nuk mund të ndryshojnë asgjë edhe pse shumica e tyre, 70% nuk ndjejnë frikë që të angazhohen në inisiativa të tilla.







Demografia e të anketuarve në qytetin e Sarandës.













5.3 Lezhë

Në bashkinë e Lezhës, rezultatet e anketimit tregojnë për një situatë jo të lakmueshme lidhur me atë sa janë qytetarët e kënaqur me shërbimet që marrin në nivel lokal. Rreth 70% e qytetarëve vlerësojnë shërbimet e bashkisë me notat më të ulta 1 dhe 2 dhe gjithashtu një shumicë prej 90% nuk konisderojnë se këto shërbime janë përmirësuar krahasimisht me vitet e kaluara.



Lidhur me nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve në zhvillimin e politikave në vend, 35% e të anketuarve konsiderojnë se kjo praktikë është e pamjafueshme, ndërsa 30% janë të bindur që kjo praktikë është e papranishme në vend. Rezultatet e anketimit tregojnë një trend negativ lidhur me vlerësimin e punës së autoriteteve lokale, ku shumica dominante ka bindjen që puna e bashkisë në raport me vitet e kaluara ka ngelur e njëjtë ose është përkeqësuar.

Korelacioni i nivelit të informimit lidhur me punën e bashkisë dhe të konsideruarit e bashkisë si institucion konfirmohet edhe në qytetin e Lezhës, ku një përqindje e njëjtë e qytetarëve – 48% konsiderojnë që nuk janë të informuar për punën e saj dhe e njëjta përqindje e konsideron bashkinë si një institucion të mbyllur për qytetarët.



Lidhur me implementimin e projekteve të miratuara nga ana e bashkisë, në Lezhë shohim një shpërndarje prej rreth 30% në vlerësimin me notat 1, 2 dhe 3. Për dallim nga bashkitë e tjera, të anketuarit nga bashkia e Lezhës japin vlerësime shqetësuese lidhur me pjesëmarrjen në inisiativave qytetare.





Rreth gjysma e të anketuarve shprehen që nuk kanë besim në organizatorët e inisiativave qytetare, gjë që e bën shumë të rëndë mobilizimin e përkrahjes publike për grupet e interesuara për inisiativa qytetare.

Akoma më shqetësues është fakti që 62% e qytetarëve të anketuar shprehen që arsyeja për t'u shmangur nga aktivizimi në inisiativë qytetare është frika nga dënimi. Ky rezultat i anketimit duhet të alarmoj konjukturat lokale në vend që ndikojnë në frikësimin e qytetarëve për pjesëmarrje demokratike në nivel lokal. Niveli kaq i lartë i pranishëm i frikës tek qytetarët hap një diskutim më të thellë dhe të komplikuar lidhur me kushtet e përgjithshme politike që kontribojnë në demobilizimin politik të qytetarëve.



Demografia e të anketuarve në qytetin e Lezhës.













5.4 Peshkopi

Rezultatet e anketimit në qytetin e Peshkopisë, që karakterizohet gjeografikisht si një zonë deri diku e izoluar dhe kufitare, në raport me shërbimet që ata i marrin në nivel lokal është mesatar dhe mesatarisht i mirë. 41% e të anketuarve i vlerësojnë shërbimet në nivelin lokal me notën 4, ndërsa 36% me notën 3. Nga të gjitha bashkitë e përfshira në këtë analizë, niveli i kënaqësisë me shërbimet në nivel lokal në Peshkopi rezulton të jetë më i lartë.

Ky rezultat në parim mund të duket kontradiktor për arsye të izolimit gjeografik të bashkisë si edhe për shkak të resurseve të kufizuara në raport me bashkitë e tjera. Mirëpo, në rastin konkret, për shkak të numrit relativisht më të vogël të banorëve dhe qasjes më të drejtpërdrejtë në administratën lokale, qytetarët e Peshkopisë kanë nivel më të lartë kënaqshmërie me shërbimet që u'a ofron bashkia.



Në raport me konstatimin e mësipërm, gjithashtu në dallim prej rezultateve nga bashkitë e tjera, gjysma e qytetarëve të anketuar të Peshkopisë e konsiderojnë bashkinë si një institucion pjesërisht të hapur. Një e treta e tyre e konsideron bashkinë si një institucion plotësisht të hapur dhe kjo paraqet përqindjen më të lartë të vlerësimit pozitiv





për bashkinë si institucion i hapur në raport me katër bashkitë tjera.

Sërisht, afërsia fizike e qytetarëve me administratën lokale në Peshkopi mund të jetë një nga arsyet e një vlerësimi të tillë, përderisa bashkitë më të mëdha kanë nevojë të adaptojnë mekanizma dhe praktika më komplekse për të afruar qytetarët që janë



në numër më të madh në punën e tyre. Për të arritur këtë bashkitë më të mëdha kanë nevojë edhe për resurse më të mëdha.

Të njejtat kushte lokale në bashkinë e Peshkopisë ndikojnë edhe në rezultatet e tjera të anketimit e që janë në koherencë me të mësipërmet. Të pyetur lidhur me atë se ata janë të informuar lidhur me punën e bashkisë, rreth 50% e tyre vlerësojnë se janë pjesërisht të informuar, ndërsa 31% vlerësojnë se janë plotësisht të informuar. Këto rezultate janë në koherencë të qëndrueshme me tezën që informimi i qytetarëve dhe bindja për atë se sa është bashkia e hapur janë në korelacion me kënaqshmërinë me shërbimet që ata marrin në nivel lokal.



Lidhur me pjesëmarrjen në inisiativa qytetare, rezultatet nga të anketuarit në qytetin e Peshkopisë tregojnë një shpërdarje të përgjigjeve në arsye të ndryshme pa një grup dominant përgjigjesh. Gjithashtu rreth 60% e tyre konfirmojnë që nuk do i shmangeshin pjesëmarrjes në iniciativë qytetare për shkak të frikës. Këto rezultate flasin për nivelin e ulët të organizimit qytetar në qytet dhe për nevojën e përforcimit të strukturave të shoqërisë civile në nivel lokal në këtë qytet.

Demografia e të anketuarve në qytetin e Peshkopisë.













5.5 Korçë

Në qytetin e Korçës, rezultatet e anketimit lidhur me pjesëmarrjen qytetare në proçesin e zhvillimit të politikave në vend është i ulët. Reth 65% e qytetarëve pjesëmarrejn e tillë qytetare e vlerësojnë me notat 2 dhe 3. Vlerësimi i të anketuarve lidhur me perceptimin e tyre për atë se sa bashkia e tyre është një institucion i hapur lidhet me rezultatet e përgjigjeve në vijim dhe konfirmon një nivel apatie tek qytetarët.

Përderisa 70% e tyre e konsiderojnë bashkinë si një institucion pjesërisht të hapur, ata



në nivel prej 41% deklarohen që nuk marrin pjesë në inisiativa qytetare si shkak i mosbesimit ndaj organizatorëve. Si edhe në disa nga qytetet tjera, ky rezultat është drejtpërdrejt i lidhur me mungesën e modeleve dhe rasteve të suksesshme të inisiativave qytetare në nivel lokal. Mosaktiviteti i tyre si rezultat i apatisë vërehet edhe në përgjigjet në pyetjen rreth frikës së mundshme, ku një shumicë prej 75% deklarojnë se nuk kanë frikë të marrin pjesë në inisiativa qytetare.

Një vlerësim pak më i mirë nga rezultatet e anketimit është ai rreth shërbimeve që qytetarët i marrin nga bashkia e Korçës. Nga vlerësimi me notën nga 1 deri në 5, 35% e të anketuarëve kanë dhënë notën 3, ndërsa 37% notën 4.





Vlerësimi i tyre lidhur me informimin e punës së bashkisë është gjithashtu i ulët, ku 50% e qytetarëve kanë vlerësuar me notën 3 ndërsa 42% e notën 2. Të njëjtat vlerësime qytetarët e Korçës i japin edhe për atë se sa realizohen projektet e miratuara nga ana e bashkisë.









Demografia e të anketuarve në qytetin e Korçës.











III.
Përfundime

6. Përfundimet nga fokus grupet, intervistat dhe forumet

6.1 Tiranë

Propozojmë që qyteti i Tiranës të ketë një ndarje territoriale dhe me këtë marrim parasysh krijimin e “lagjeve”. Këto struktura lokale që do mund të krijoheshin nëpërmjet bordeve që do votohen nga vetë banorët janë jo vetëm një rritje e vetëdijes qytetare, por dhe një mundësi e mirë për të krijuar komunitet. Ne mendojmë që lagjet duhet të jenë me një numër të caktuar banorësh dhe një koncept gjeografik që e përbën atë si komunitet (blloqe pallatesh etj). Përveç aspektit demokratik të përfaqësimit sidomos në zonat urbane që do sillte kjo gjë kur të rregullohet me gjyq, këto entitete do kenë mundësi jo vetëm të përfitojnë nga fonde lokale por dhe të aplikojnë për fonde ndërkombëtare, si psh fondet e BE që e njohin dhe e mbështesin këtë koncept të organizmit vullnetar lokal. Këto lagje do mund të rregulloheshin me ligj, jo vetëm mënyrën e përzgjedhjes dhe misionit të organizmit të brendshëm, por gjithashtu dhe të rregullohen nëpërmjet këtij ligji marrdhëniet me strukturat e bashkisë në formë zyrtare.

1200 administratorë pallatesh janë sot të liçencuar në bashkinë e Tiranës, komunikimi me ta është i frytshëm, dhe kjo ka sjellë që këta administrator jo vetëm kanë arritur të identifikojnë problemet komunitare, por të jenë një grup i rëndësishëm njerëzish dhe për të mobilizuar në raste emergjencash natyrore. Mbulimi i gjithë Tiranës me administrator të liçensuar duhet të jetë një prioritet.

Sa u përket pjesës së shërbimeve sociale që sot janë në Ministri, ato duhet të kalojnë në Bashki, dhe administrata lokale të jetë përgjegjëse për shërbimin social dhe përkujdesjen për ata që janë më të pamundur me një qark të mbyllur të gjithë proçesit brenda vetes së vet. Dualizimi i kompetencave me qeverinë qëndrore sjell probleme dhe burokraci që njerëzit me aftësi të kufizuara apo të tjerë njerëz në nevojë duhet mos ti pësojnë. Për këtë duhet ndërmarr një reformë të decentralizmit të plotë të këtij shërbimi. Gjithashtu ka shumë institucione që duhet të decentralizohen në nivel lokal, por mungesa e bërjes me shpejtësi të ligjeve dhe akteve nënligjore e ka ngadalësuar këtë proçes.

Një nga pikat më të rëndësishme të reformës territoriale është edhe zhvillimi i “One Stop Shop” dhe shërbimeve online . Ofrimi i shërbimeve online dhe sidomos krijimi i “One Stop Shop”, që do mund të afronte këtë shërbim në zyra të unifikuara ka filluar të pilotohet me sukses në disa bashki, e tani do duhet të avancojë edhe më shumë. Pritet që deri në 2020 70% e shërbimeve të jetë online.

Një tjetër projekt që ka ardhur online tek qytetarët është edhe ai i lejeve të ndërtimit. Projekti ka sjellë një kontroll më të madh të territorit kur vjen puna për menaxhimin e ndërtimeve pa leje, por duke pasur parasysh zhvillimin e teknologjisë në zonat rurale do duhet që të ketë për çështje të vogla dhe një shërbim në vend sidomos në zonat rurale në njësitë administrative përkatëse. Në këto kushte disa prej këtyre shërbimeve mund të decentralizohen nga bashkia në njësitë administrative, për të qenë sa më afër banorëve që kanë probleme dhe gjithashtu për të bërë të mundur shmangien e pritjeve dhe burokratizimit e centralizmit të vendimarrjes.

Gjithashtu një ndërhyrje duhet edhe në rikonceptimin e ndërlidhesave të komunitetit duke i shtuar pagesat e duke i bërë pjesë të njësive administrative me detyra të

përcaktuara në ligj. Këto ndërlidhësa dhe kryepleqtë duhet të kenë një organizim ligjor në formën e sindikatës që të njihet me ligj dhe të mbrohen nga zëvendësimet dhe pse nuk janë nënpunësa publik. Në vetvete duhet të ndërtohet një sistem për raportimin e ndërlidhësave të komunitetit në zonat urbane dhe rurale në mënyrë që të vlerësohet dhe angazhimi e performanca e gjithsecilit.

Duhet të fillojë një fushatë e informimit të banorëve jo vetëm për mënyrat se si mund të influencojnë politikat bashkiake (aplikacionet e ndryshme, email, kërkesa etj) por mbi të gjitha për të qartësuar banorët se cilat janë institucionet e reja që janë zhvendosur nga qeveria qëndrore në bashki dhe me ndryshimet e reja për institucionet brenda strukturës lokale që i pergjigjen problemeve të tyre.

Gjithashtu këshilltari bashkiak duhet të ketë detyrim ligjor për të organizuar takime periodike për të informuar banorët për investime apo politika të bashkisë që prekin zonat në të cilat ata janë votuar. Buxhetimi me pjesëmarrje do duhet të ndryshoj format duke bërë të mundur që nëpërmjet këshilltarëve bashkiak të vijnë propozime përpara se të hartohet buxheti apo nëpërmjet një platforme online që do mund të ishte transparente për këto propozime. Buxhetimet me pjesëmarrje zakonisht janë prezantime të bashkisë për planet që ka në zonë, ndërkohë duhet të ketë diskutime me banorët para planeve që bëhen për zonën.

6.2 Sarandë

Në reformën territoriale duhet të parashikohen ndryshimet e personelit në bashkitë si Saranda, që shumifishohet në banorë gjatë sezonit veror. Në keto kushte duhet të ketë një zhvendosje dhe të shërbimeve të përkohshme që nuk janë të parashikuara në rregullore. Në këtë periudhë të vitit mbetet problem menaxhimi i mbetjeve dhe i shërbimeve publike nga ndërmarrjet publike të qytetit si dhe në pjesën e fshatrave që lidhin Sarandën me Ksamilin. Banorët gjatë sezonit veror shprehin pakenaqësinë ndaj shtimit të qenëve, insekteve dhe ekzistencën e erës së keqe në zonë.

Një problem që shfaqet gjatë periudhës së sezonit veror është edhe shtimi i trafikut, gjë që sjell dhe potencial të incidenteve të paparashikueshme. Periudha e sezonit veror bën të mundur sjelljen e shumë turistëve vendas dhe të huaj, gjë që duhet të reflektohet dhe tek stafet mbështetëse që duhet të jenë në gadishmëri të plotë e të vazhdueshme,

si në numër ashtu edhe në shërbim. Sezoni veror përkon dhe me shtimin e policisë rrugore, mjekëve etj.

Kjo zonë e Shqipërisë nga shumë prej banorëve dhe autoriteteve lokale konsiderohet e vdekur jashtë sezonit turistik veror, që në vitet e fundit ka ardhur duke u përqëndruar kryesisht përgjatë muajit gusht. Kjo i vështirëson së tepërmi kushtet ekonomike të banorëve të këtyre zonave që shpesh kanë qenë pre e kritikave për çmime më të larta se duhet përgjatë sezonit duke sjell pakënaqësi të shpeshta. Ky është tregues i tentativës së tyre për të shfrytëzuar e kapitalizuar të vetmin burim që kanë në dorë.

Propozimi do të ishte i ndërhyrjes së autoriteteve me programe të mirëmenduara për zgjatjen e sezonit, madje krijimin e mundësisë të zhvillimit të turizmit të aventurës apo atë kulturor- edukativ. Kjo është mëse e realizueshme duke marrë në konsideratë faktin që fare pranë qytetit të Sarandës ndodhet qyteti antik i Butrintit i shpallur pasuri botërore e i mbrojtur nga Unesco, e gjithashtu vende natyrore piktoreske të rralla në botë si Syri i Kaltër. Por mos mirëmbajtja e tyre dhe mungesa e stafeve të nevojshme apo investimeve në infrastrukturë i kthen këto pasuri në burime të ardhurash të dorës së tretë.

6.3 Lezhë

Në Lezhë kemi disa probleme që dalin nga situatat administrative. Ndryshimet në ligj nuk janë reflektuar me një fushatë ku qytetarët të jenë të informuar për kompetencat e ndryshuara të institucioneve, për pasojë ka një kaos në kërkesën e llogarisë qeë banorët duhet të kenë ndaj institucioneve lokale. Problemi mbetet i dyanshëm, sepse dhe institucionet vendore nuk janë të qartë plotësisht për punën e tyre sidomos tek rekrutimi i punonjësve, në shumicën e rasteve ka një mungesë logjike në rekrutimin e tyre duke pranuar më shumë në disa sektorë dhe më pak në disa sektorë të tjerë.

Kjo tregon që ligji i administratës publike duhet të jetë më i qartë në rekrutimin e punonjësve.

Gjithashtu problem që rrjedh prej kësaj situate është edhe rekrutimi i punonjësve që duke qenë se mbetet në dorë të administratorit madhësia institucionale shpeshherë

rekrutohen pa kualifikimin e përshtatshëm dhe në vende jashtë profilit. Mundësia është që këto anomali që janë krijuar gjatë kësaj kohe të plotësohen me trajnime të administratës, ose me një projekt kombëtar që do i shërbente jo vetëm formimit administrativ të punonjësve lokal, por dhe një kohezion për të qartësuar tranzicionin me adminsitratën e re lokale dhe kompetencave të saj që janë ndryshuar me ndryshimin e reformes territoriale.

Strukturat lokale duhet të kenë më shumë hapësirë vendimarrje kur vjen puna tek institucionet e edukimit, siç janë shkollat kopshtet apo çerdhet, duke identifikuar më qartë përgjegjesinë dhe duke e pasur në lokalitet dhe për banorët është më e lehtë që të ndërtohet një raport kërkesë/dhënie llogarie sa më afër vendbanimit që është dhe thelbi i demokracisë lokale. E njëjta gjë vlen për zonat bujqësorë, një qytet si Lezha që zhvillimin ekonomik e sheh dora dorazi me zhvillimin rural, ku po krijohet dhe një koloni interesante kulinarie kulturore në zonë, e sheh si domosdoshmëri afrimin e këtyre kompetencave të drejtorive bujqësore bordeve të kullimit etj në administratën lokale.

Sa i përket strukturës së Këshillit bashkiak e cila përbëhet nga komisionet, të cilët diskutojnë propozimet e bashkisë ose të grupeve të interesit për t'u votuar në këshill. Këto komisione janë inekzistente dhe nuk funksionojnë, kështu që shumica e ligjeve kalojnë për t'u votuar pa kaluar më parë te këto komisione. Kjo gjë tregon se duhet forcuar roli i komisioneve bashkiake në mënyrë që të rritet pjesëmarrja qytetare dhe për pasojë vendimet të jenë sa më demokratike kur propozohen për fazën finale në këshillin bashkiak dhe që bëhen ligje për qytetin.

Një nga gjërat që është përkrahur më shumë në Lezhë ka qenë dhe dixhitalizimi i shërbimeve. Dixhitalizimi i ndihmës ekonomike ka sjellë shmangien e abuzimeve dhe vlerësimin e barabartë të anëtarve të komunitetit. Shërbimet online rrisin besueshmërinë dhe shmangin abuzimet në perceptimin qytetar. Këtë banorët e shohin si e ardhmja e shërbimeve të qytetit.

Në Lezhë banorët janë entuziastë me reformën e re territoriale se e shohin atë si një mundësi më të madhe për të mbledhur më shumë taksa dhe për pasojë për të pasur më shumë investime në të mirën publike. Kjo sjell që të gjenden format që pikërisht këto të ardhura të kenë një pjesëmarrje më të madhe qytetare kur vjen puna tek ndarja dhe përcaktimi i buxhetit të bashkisë për investime. Megjithkëtë mbetet problem për demokracinë lokale plani i decentralizimit 2014-2020 është duke ecur shumë ngadalë dhe shumë kompentenca që duhet t'i kalonin pushtetit lokal mbeten akoma varur.

6.4 Peshkopi

Pushteti vendor duhet të centralizojë shërbimet në Administratën vendore (bashki). Kjo e ben kërkesën e llogarisë më afër qytetarit, dhe bën të mundur një koordinim më të madh të punës, sidomos kur vjen fjala në Bashki si ajo e Peshkopisë që janë larg qendrës.

Strukturat e Bujqësisë, dhe varësia e tyre nga Institucionet e qeverisë qëndrore sjellin problem në koordinimin e punëve, edhe pse që në fillim të reformës territoriale është bërë një plan se si drejtoritë sidomos ato bujqësore do kalojnë në administrimin e bashkive, përsëri kjo punë nuk ka ndodhur, për Peshkopinë kjo është shumë e rëndësishme si bashki me një zonë të madhe rurale që përdoret për blegtori dhe bujqësi.

Struktura të tjera siç janë ato të Arsimit apo Shëndetësisë që janë të varura nga Ministritë përkatëse mund të transferojnë disa prej kompetencave në administratën lokale. Sidoqoftë në funksion të demokracisë dhe adminstrimit shihet me pozitivitet një decentralizim i punëve nga Qeveria qëndrore në Tiranë në Administratat lokale të Bashkive, nuk shihet si diçka pozitive pastaj delegimi nga Adminstrata qëndrore e Bashkive, në qendrat Administrative, kjo dhe për faktin që administratorët janë të vendosur nga vetë kryetarët e bashkive si poste administrative dhe jo politike e për pasojë nuk kanë të drejtë menaxhimi të fondeve apo vendimarrje sipas ligjit te ri.

Me ndarjen administrative, mini bashkitë janë zëvendësuar me administratorët përkatës, ndërsa kryetarët e komunave sot vendosen nga Kryetari i Bashkisë dhe jo të votuar siç ka qenë me ligjin e vjetër. Kjo ka sjellë që vendimarrja të jetë e centralizuar, por dhe pse Administratorët janë të vendosur si poste administrative nga kryetarët e bashkive ata nuk përballen me kriteret e rekrutimit në Administratë, duke u trajtuar kësisoj si staf politik. Pjesëmarrësit sugjerojnë që administratorët të vazhdojnë të vendosen nga kryetarët e bashkive për të qenë sa më afër qytetarëve dhe kjo i ndihmon demokracisë, po të zbatohen kushtet e rekrutimit siç aplikohen në administratë.

Meqënëse tashmë ka ndodhur ndarja administrative dhe nuk pritet të shihet një rishikim i hartës administrative, Bashkia e Peshkopisë është një Bashki, e cila nuk arrin dot të mbijetojë vetëm nëpërmjet forcimit të mbledhjes së taksave, kjo për dy arsye, e para për numrin e banorëve dhe e dyta më e rëndësishmja si pasojë e varfërisë. Për këtë arsye duhet riparë fondi që ndahet për bashkitë sidomos në kuptimin social, dhe duhet të ketë një analizë më të mirë për investimet që duhet të vinë në këtë bashki. Mendojmë që dhe në përcaktimin e fondit qëndror do duhet të ketë një analizë që do mund të kishte qoftë plan investimesh dhe një mundësi që nëpërmjet këtyre investimeve të rritet numri i të punësuarve dhe nëpërmjet kësaj të ndryshojë situata ekonomike e zonës, për

ta bërë atë të qëndrueshme në afatgjatë.

Për arsye të gjendjes ekonomike të zonës dhe varfërisë së saj, zona të mëdha të Bashkisë Peshkopi (e cila numëron 16 njësi administrative) janë të pambuluara nga furnizimi me ujë, kjo vjen sepse Ujësjellësi del me humbje dhe nuk ka mundësi të investoj për të bërë investime të reja e të mbuloj zonën me ujë, kësisoj do duhet që dhe këto ndërmarrje publike në menyrë që të jenë funksionale dhe jo një vend ku thjesht punësohen njerëz të subvencionohen nga shteti, pra një prej problemeve sociale është furnizimi me ujë i banorëve të zonës.

Menaxhimi i mbetjeve është një problem kryesor në Bashkinë e Peshkopisë. Centralizimi i këtij proçesi me reformën e re territoriale ka sjellë që ky shërbim të jetë i përqëndruar në qytetin e Peshkopisë. Duke qenë se Bashkia e Peshkopisë ka shumë njësi Administrative dhe një rrjet infrastrukture që e bën të vështirë mbulimin e shumicës së tyre, për arsye të terrenit malor, duhet rishikuar mundësia për të decentralizuar këtë shërbim dhe disa qëndra me një logjikë gjeografike që mbledhja dhe menaxhimi i mbetjeve të bëhet në gjithë njësinë administrative të Bashkisë së Peshkopisë.

Menaxhimi i pyjeve në këtë zonë ngelet një prioritet dhe sfidë për Bashkinë e Peshkopisë. Duhet një ligj i ri për menaxhimin e pyjeve. Me ligjin aktual, pushteti lokal vetëm mund ta lajmëroj qendrën për abuzime të mundshme. Në këto kushte do duhet një decentralizim në nivel lokal që ky inspektoriat të jetë më afër terrenit dhe reagimi të jetë i menjëhershëm.

6.5 Korçë

Në rajonin e Korçës duhet një analizë demografike dhe një parashikim i zhvendosjes së popullsisë. Ka një përcaktim shërbimesh të cilat lidhen më shumë në mënyrën klasike të të pasurit institucione në qëndrat e fshatrave kryesore, por me kalimin e viteve ndryshimet e mëdha demografike, zhvendosja e popullsisë ka krijuar probleme të mëdha në menaxhimin e shëndetësisë dhe arsimit.

Këto institucione varen nga qeveria qëndrore, ndërkohë duhet të ketë qeverisja lokale më shumë hapësirë për të drejtuar jo vetëm në kuptimin e infrastrukturës por dhe të burimeve njerëzore duke qenë se është më fleksibël për t'u përgjigjur ndryshimeve drastike ku fshatra të tërë janë duke u zbrazur dhe periferitë e zonave urbane janë duke u populluar më shumë. Duhet një qasje e re sidomos në dhënien e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore që ti përgjigjet ndryshimeve demografike.

Gjatë evidentimit të problemeve në zonë, u vu re se mungesa e zyrave dhe vëmendjes së mbledhjes dhe përpunimit të statistikave ka sjellë shumë probleme në zonë. Nëse bashkia do kishte të integruar një zyrë të mirë statistikash atëherë do mund të kishte jo vetëm më shumë informacion por dhe do mund të ndihmonte.

Duke pasur parasysh zonën e Kroçës, që është një zonë atraktive në fushat e turizmit dhe bujqesisë e investimeve të huaja, në mungesë të statistikave dhe të të dhënave e kanë të pamundur, që të ndërtojnë biznes-plane, që mund të ndikojnë në zhvillimin e zonës. Ne rekomandojmë që të ketë një planifikim jo vetëm të transferimit të shumicës së institutit të statistikave të nivelit lokal në bashki, por të ketë edhe një shtim të numrit të punonjësve dhe detyrave për të mbledhur të dhëna nga terreni. Këtu mund të shtohet dhe një marrje periodike e mendimit të qytetarëve për politikat e bashkisë, me anë të pyetësorëve apo anketave, që kryhen në mënyrë profesionale nga zyrat lokale të statistikave dhe të cilat janë periodike dhe mund të marrin një kampion përfaqësimi përgjatë gjithë bashkisë së Korçës.

Në zonën e Korçës e cila është një nga zonat më të angazhuara në Shqipëri në bujqësi, ka ndikuar negativisht mungesa e qartesisë së kompetencave, që ka sjellë reforma territoriale sidomos kur vjen puna tek menaxhimi i bujqesisë. Ky është një problem i hasur dhe në bashki të tjera të marra në këtë studim, por është e theksuar në zonën e Korçës sidomos për potencialin, që ka kjo zonë. Duhet qartësuar dhe përshpejtuar decentralizimi i institucioneve që tashmë është dakortësuar me votimin e reformes së re territoriale.

Një tjetër problem i madh që kanë banorët sidomos sa i përket shërbimeve të rëndësishme, siç është pastrimi apo dhe ndriçimi, kompetenca këto që me ligjin e vjetër kanë qënë të decentralizuar nëpër njësi komunale apo minibashki, kanë mbetur të paadresuara në reformën e re territoriale, ku shumica e këtyre shërbimeve janë centralizuar në qëndrat e zonave urbane. Në këto kushte, duhet të përcaktohet qartë një lloj decentralizimi apo funskionimi i këtyre shërbimeve që dhe në zonat e largëta me pak banorë (për pasojë dhe me pak peshë politike) të krijohet mundësia që shërbimi të merret njësoj sidomos kur vjen puna për shërbimet kryesore siç është ndriçimi, pastrimi etj

Evidentim tjetër që është hasur në qytetin e Korçës është edhe ajo e mbledhjes së taksave, e cila nuk behet siç duhet në pjesën rurale të bashkisë. Duhet ndërtuar nje strukturë e re për mbledhjen e taksave e cila e mer parasysh dhe aspektin e zmadhimit gjeografik të bashkive por dhe shpeshherë mungesa e dhënies së shërbimeve shkon dora dorazi me një tolerim të mbledhjes së taksave duke krijuar kështu zona që mund të quhen periferia e periferisë, kujdesi për të ndërtuar një sistem funksional të mbledhjes së taksave prodhon dhe një detyrim për të çuar shërbimet, prandaj dhe pjesëmarrja në këtë aktivitet pa dallim garanton dhe një kërkesë llogarie dhe zhvillimi të pjesëmarrjes demokratike në tëe gjithë territorin në menyrë të barabartë.

Ndarja e re territoriale duhet të shoqërohet me një ndryshim rrënjësor në ligjin e mbajtjes së referendumeve lokale. Mënyra e vetme për të garantuar një pjesëmarrje në momentet më të rëndesishme të qytetit, sidmos në këto bashki të mëdha dhe me një diversitet territorial kaq të madh, do duhet të rishikohet gjithë ligji për referendumet lokale, jo vetëm për ti bërë ato sa më të aksesueshme, por mbi të gjitha për ti përcaktuar qartë në ligj se kur janë rastet kur ato mund të mbahen e gjithashtu dhe për të lehtësuar proçesin e kohës që duhet për ta bërë të mundur një referendum të tillë.

Tjeter rol i rëndësishëm për t'u parë dhe adresuar është ai i punësimit të grave dhe të

rinjve, të cilët kanë mangësi të mëdha, dhe nuk ka plane qeveritare të mirëfillta sidomos në nivel lokal për ta përmirësuar situatën e këtyre grupeve. Duhet një vëmendje më e madhe për të permirësuar bazën ligjore dhe për të bërë të mundur njohjen dhe përballjen me këtë problem.

Ndërtimi i strukturave rajonale, ka pasur një agjensi të zhvillimit të rajoneve që u krijua pastaj u shkri brenda fondit të rajoneve, duhet gjetur mënyra për të krijuar një agjensi zhvillimi rajonal, sidomos për të bashkërenduar projekte në fusha të ndryshme, si ajo e bujqësisë apo zonave industriale që mund të gjenden në më shumë se një bashki përshembull "fusha e Maliqit" është një zonë ekonomike bujqësore që përfshin dhe bashkinë e Korçës dhe atë të Maliqit, pra kur vjen puna për politika zhvillimi duhet bërë një arsyetim në kuptimin ekonomik jo vetëm territorial dhe kjo duhet të jetë e reflektuar në propozime ligjore.

7. Përfundime mbi programin e transparencës

Në kuadër të programit të transparencës bashkitë e marra në analizë shfaqin performanca të ndryshme.

Bashkia Tiranë ka web-faqen me informacion më të pasur nga bashkitë e tjera në sasi projektesh dhe aktivitetesh të implementuara dhe të pasqyruara. Në webin https://tirana.al/ mund të gjendet seksioni i vecantë i dedikuar transparencës ku ka zëra të vecantë për secilin projekt dhe një rubrikë të posacme për buxhetin duke bër publike tabelat e planifikimit të buxhetit dhe të raportmit të tij. Mund të gjenden evidenca e Realizimit të Investimeve dhe Realizimi i të Ardhurave qe prej vitit 2014 e në vazhdim. Në këtë aspekt informacionin më të plotë e ka shpërndarë me publikun Bashkia Korcë, e cila ka vënë në dispozicion të qytetarëve jo thjesht koncentratin e buxhetit por cdo publikim e ka shoqëruar me raport të detajuar, që jo pak herë i kalon të 150 fletët, duke nisur që nga viti 2007 e ne vazhdim.



Në Webin e Bashkia Tiranë mund të gjenden këto Transparenca: Buxheti; Open Data; KET; Programi i transparencës; Konsultimi Publik.

Bashkia Lezhë i ka dedikuar një seksion të posacëm programit të transparencës në faqen kryesore: http://www.lezha.gov.al/web/Programi_i_Transparences. Por në brendesi jo të gjitha lidhjet, që ofrojnë mundësinë për të kërkuar informacion të mëtejshëm janë funkionale.



Ndërkohë, që informacione të tjera si vendime të Këshillit Bashkiak apo regullore se si mund të adresohen shqetësime të ndryshme nga ana e qytetarëve janë të renditura qartë dhe të lehta në përdorim. Mbi buxhetin mund të gjendet informacion deri në vitet 2015-2016 por jo më vonë nën kategorinë: vii. Regjistrat e prokurimeve publike ; Regjistri i parashikimeve te prokurimeve publike per vitin 2015, 2016 dhe Regjistri i realizimit te prokurimeve publike per vitin 2015, 2016.

Bashia Dibër ka të publikuar në web-faqen zyrtare http://dibra.gov.al/transparenca/ Programin e transparencës ku mund të gjenden të dhëna mbi; Organizimin dhe Funksionimin e Bashkisë; Transparenca dhe Llogaridhënia EkonomikoFinanciare; Kërkesat për informim; Shërbimet që ofron Bashkia; Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore; Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje si dhe Informacione të tjera. Gjithashtu ka të renditura këto rubrika në shërbim të transparencës me qytetarët:



- Kalendari i prg buxhetor afatmesem&vjetor
- Paketa Fiskale
- Plani strategjik i zhvillimit të bashkisë
- Programi buxhetor afatmesëm vendor
- Buxheti vjetor
- Zbatimi i buxhetit
- Monitorimi, mbikëqyrja dhe auditimi i buxhetit
- Vështirësitë financiare
- Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve
- DonacionetKëto të dhëna janë të pasqyruara, që prej 2007 e në vazhdim.



Bashkia Sarande nuk e ka një rubrikë të posacme për transparencën. http://bashkiasarande.gov.al - Në web-faqen e Bashkisë Sarandë mund të gjenden Projekt vendimet për buxhetet e viteve 2016-2017 por jo raportet mbi realizimin e tyre. Ekziston një mundësi për tu ridrejtuar në faqen e mundësuar nga projekti Star II ku mund të gjenden të gjitha vendimet e Këshillit Bashkiak të Sarandës së bashku me gjithë vendimet e gjithë Keshillave Bshkiak të tjerë. http://www.vendime.al/vendimet-e-keshillit-bashkiak-sarande/



Bashkia Korçë ofron pasqyrën më transparente të Buxhetit nga të gjitha bashkitë e tjera të marra në analizë. Në buxhetin e Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë janë pasqyruar të gjitha burimet e financimit, shpenzimet dhe financimet e pushtetit vendor.



IV.
Rekomandime

8. Rekomandime

- Ka nevojë për përforcimin e organizatave të shoqërisë civile dhe stukturave lokale që merren me çështje konkrete lokale si për shembull ujësjellësi, menaxhimi i mbetjeve, arsimi në nivel lokal, etj, përmes fokusimit të përkrahjes nga ana e donatorëve për probleme konkrete në zona të caktuara. Një qasje e tillë e përkrahjes do të rriste besimin e qytetarëve në inisiativa lokale dhe do të nxiste replikimin e rasteve të suksesit. Bashkitë kanë kapacitete për të adresuar kërkesat e qytetarëve por ata shpesh nuk vihen nën presion nga ana e tyre. Rritja e kërkesës qytetarë për pjesëmarrje në vendimmarje në nivel lokal mund të sjellë në afat të shkurtër përmirësim të dukshëm të shërbimeve.

- Gjithashtu, përveç organizatave formale, duhet të vendosen në funksion edhe strukurat e ndërmjetme të përfaqësimit të banorëve të cilat janë dhe përgjegjëse për të monitoruar shërbimet që jepen nga niveli lokal apo qëndror. Ketu duhet pasur parasysh kryepleqtë që veprojnë në zonat rurale dhe ndërlidhësit e komunitetit që operojnë në zonën urbane. Gjithashtu duhet të krijohen borde të strukturave lokale dhe qëndrore të cilët do të kenë takime të përmuajshme ku do të diskutohen problematikat qe vijnë nga ndërlidhësit e komunitetit (si psh. përfaqësuesit e bashkisë, spitalit, policisë, shërbimit social etj.)

- Për qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, Elbasani, etj. rekomandojmë krijimin e strukturave të lagjeve të cilat do të zgjidhen nga vetë banorët dhe do të përfaqësojnë tërësi logjike urbanistike të qyteteve (si psh. bllok pallatësh) dhe që përfshijnë jo më shumë se 20 mijë banorë. Këto struktura mund të shërbejnë si katalizatorë lokal, grupe konsulence për shpërndarjen e buxhetit dhe të cilat zyrtatrisht do të jenë të njohura nga Bashkia si struktra të ndërmjetme vullnetare. Nëpërmjet krijimit të formave të 'lagjeve' do të forcohet jo vetëm komuniteti brenda këtyre strukturave që si pasojë e ndryshimeve demografike urbane i ka tjetërsuar ato, por edhe do të mundësojë shtrirjen e vendimmarjes nga posht -lartë.

- Një nga mënyrat e adresimit të problemit të shkëputjes së institucioneve nga njëri-tjetri që për pasojë ka mos koordinimin e punës në terren, sidomos për pjesën më të prekshme shoqërore, është krijimi i një bordi formal, të parashikuar me ligj në çdo bashki. Këto borde do të punojnë më kryepleqtë dhe ndërlidhësit sipas detyrave të përcaktuara qartë për të përfaqësuar komunitetin. Për të funksionalizuar këtë formë të punës në nivel lokal ku ndëridhen shërbimet dhë përfaqësimi ka nevojë që të rriten kapacitetet e këtyre aktorëve në nivel lokal.

- Duhet të zhvillohet një kornizë më e mirë ligjore lidhur me referendumet si një nga mënyrat e vendimmarrjes lokale për çështje të rëndësishme, veçanërisht ato lidhur me projektet zhvillimore, projektet e urbanizimit dhe ndërtimeve që mund të ndikojnë në masë më të madhe jetën e banorëve. Duke pasur parasysh që përvoja me referendum lokale në Shqipëri është pothuajse joekzistuese, strukturat institucionale dhe ato të shoqërisë civile duhet që të zhvillojnë disa projekte-pilot dhe të eksperimentojnë modele të ndryshme se si referendumet mund të aplikohen në nivel bashkie.

- Edhe pse në Shqipëri ekziston forma e referendumit lokal, ai mbetet gjithmonë në diskrecion të qeverisë për të përcaktuar nëse një referendum është lokal apo kombëtar (psh. rasti i TEC-it në Vlorë). Proçedurat pranë KQZ për referendum lokal janë po ato si edhe për referendum kombëtar me ç'ka vështirësohet qasja në këtë mjet demokratik për inisiativat lokale. Ka nevojë që të përcaktohet me ligj se në cilat raste referendumi lokal është legjitim dhe gjithashtu të përcaktohen strikt përjashtimet lidhur me të cilat nuk mund të vendoset në nivel lokal, zakonisht për rastet që kanë të bëjnë më interesin kombëtar. Pas këtij përcaktimi ligjor, lehtësimi i këtij mjeti demokratik mund të realizohet duke shfrytëzuar platforma online të krijuara ekas për realizimin e referendumit lokal si e-peticionet, e- iniciativat dhe buxheti me pjesëmarrje.

- Drejtoritë e punëve publike duhet të vendosin dhe aplikojnë mekanizma të transparencës lidhur me planifikimin dhe realizimin e projekteve publike, përpara së këto të miratohen nga Këshillat Bashkiak ku ka një praktikë më të mirë të transparencës. Duke vendosur praktika transparente në fazat përgatitore, qytetarëve do t'u jepet mundësia të informohen lidhur me planet aktuale dhe të kyçen në fazë më të hershme për ti adresuar nevojat e tyre. Me rreth 50% të buxhetit që bashkitë e mëdha mbledhin nga taksa e ndërtimit ata kanë mjaftueshëm fonde për të zhvilluar platforma punësimi për këto dy grupe. Këto praktika duhet të përcaktohen me ligj dhe çdo procedurë tenderimi të kalojë përmes organeve përfaqësuese të Bashkisë siç janë komisionet dhe këshilli.

- Sa i përket shërbimeve në nivel lokal në zonat rurale (fshatra) logjika e qasjes territoriale duhet të korrigjohet me parametrat demografike. Duhet vendosur një kornizë minimale e numrit të banorëve për njësi administrative me ç'ka do të evitohen bashkitë që me kapacitetet e tyre të kufizuara nuk kanë mundësi të ofrojnë shërbime të kënaqshme për banorët e tyre. Sipas kësaj logjike, korrigjimi i organizimit territorial do ti bashkonte zonat me popullsi shumë të vogël më një bashki më të afërt me më shumë kapacitete. Kësisoj do të realizohet edhe një menaxhim më i mirë i kostove për shërbimet në nivel lokal kualiteti i të cilave do të nivelohesh edhe në nivel vendi.

- Ndarja e tanishme territoriale gjithashtu duhet të korrigjohet në raport me zonat bujqësore të cilat për momentin janë të shpërndara në menaxhim të bashkive ku ato përkasin – pjesë të një zone rajonale bujqësore që formon një tërësi funksionale-territoriale janë të ndara në disa bashki. Për të mundësuar një menaxhim më të mirë të këtyre zonave si dhe për të mundësuar planifikim dhe zhvillim më efikas rajonal bujqësor, menaxhimi i zonave bujqësore duhet të realizohet përmes një modeli të kombinuar në mes vetqeverisjes lokale dhe autoriteteve

qëndrore – Ministrisë së bujqësisë dhe zhvillimit rajonal, duke krijuar një model decentralizimi të kushtëzuar sipas nevojave zhvillimore bujqësore rajonale. Për të realizuar sa më mirë menaxhimin me hapësirat bujqësore si dhe përcaktimin e prioriteteve për zhvillimin e biznesit prodhues duhen rritur kompetencat dhe kapacitetet e Agjensisë ekzistuese për zhvillim rajonal.

- Duhet të rriten kapacitetet për mbledhjen dhe analizën e statistikave në nivel të bashkive. Aktualisht territore të mëdha të vendit mbulohen nga një ose dy punëtorë të Instat me çka krijohet një mugesë e konsiderueshme e të dhënave. Mbledhja e të dhënave që mungojnë për kapacitetin dhe potencialin e bashkive dhe zonave do të riste mundësitë e tyre për tërheqje të fondeve dhe investimeve.
- Ekziston një numër i caktuar i bashkive që për shkak të kombinimit të kushteve gjeografike, demografike dhe ekonomike nuk i'a arrijnë të jenë ekonomikisht efiçente. Prandaj, pushteti qëndror me kombinimin e mekanizmave financiar dhe ekonomik duhet të krijojë një fond të pakushtëzuar për këto bashki. Aksesi në këtë fond duhet të rregullohet në bazë të një indeksi përmes të cilit do të vlërësohet niveli i kontributit për secilën bashki jo efiçente ekonomikisht.

Rreth ISSH

Instituti i Studimeve Sociale dhe Humane paraqet një qendër të studimit të politikave si dhe qendër akademike për hulumtimin dhe studimin e dinamikave bashkëkohore sociale. ISSH është një organizatë jo-fitimprurëse dhe shkencore/hulumtuese, që sjell së bashku një ekip me përvojë të përbërë nga studiues, analist politikë, teoricien dhe aktivistë. Ai ka për qëllim të interpretojë trendët e pranishme shoqërore brenda shoqërisë shqiptare me një fokus të fortë në ofrimin e një qasje inovative për praktikën e hulumtimeve dhe analizave në vend. Ai synon drejt anailzës së trajektoreve të zhvillimit dhe riformimit të diskurseve të pranishme në vizionin për shoqërinë shqiptare dhe rajonit të Ballkanit në përgjithësi.

Puna e Institutit udhëhiqet nga angazhimi i anëtarëve të tij për vlerat emancipuese dhe barazisë, lirisë dhe drejtësisë sociale, parime të cilat duhet të shërbejnë si një motor kryesor i politikave dhe praktikave gjatë procesit të transformimit social në Shqipëri. Instituti ka bazuar aktivitetin e tij në praktikën shoqërore, ku bashkëveprimi i aksionit të qytetarëve, praktika institucionale dhe ngjarjet politike përcaktojë kompleksitetin e kontekstit aktual në Shqipëri. Është ky konteksti që ne synojmë për të analizuar, menduar dhe ri formatuar duke u angazhuar me një gamë të gjerë të aktorëve që marrin pjesë në mënyrë aktive në modelimin e kushteve aktuale të potencialeve socio-ekonomike, kulturore dhe politike të shoqërisë shqiptare. Instituti nxjerr metodën e tij interpretuese nga procesi i dekonstruksionit dhe rikontekstualizimit të teorive bashkëkohore në fushat e sociologjisë, antropologjisë, ekonomisë, teorisë kritike kulturore, studimeve gjinore, etj. , përmes përshtatjes së tyre me nevojat aktuale të kontekstit në Shqipëri.

Qasja multidisiplinare për hulumtim dhe analiza, i mundëson ekipit të Institutit që të nxjerr modelet dhe tendencat, si dhe anomalitë nga fenomene aktuale sociale në mënyrë që të arrijë të specifikojë interpretimet e rrymave themelore shoqërore dhe sistematike që përcaktojnë manifestimet e përditshme në sferën e hapësirës publike si edhe diskursit, ekonomisë, kulturës dhe arsimit.

Instituti angazhohet në adresimin e nevojave imediate politike, përmes analizës së politikës dhe çështjeve kulturore në Shqipërinë e sotme me avokimin për ndërhyrjet që çojnë në ndërtimin e një procesi më të homogjenizuar të transformimit shoqëror. Një proçes që nuk rrit kontradiktat shoqërore, por që kontribuon në përgjithësi për barazinë përbrenda komunitetit. Ai propozon politika që mundësojnë një mjedis pjesëmarrës dhe demokratik si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal të qeverisjes, duke kontribuar kështu në kyçjen aktive politike të qytetarëve në njërën anë dhe në rritjen e kapaciteteve demokratike dhe forcimin e institucioneve shtetërore nga ana tjetër.

Instituti ka për qëllim të mundësojë dhe të kontribuojë në forcimin e proçeseve që gjenerojnë hapësira të reja sociale për angazhim, diskutime dhe shkëmbim të argumenteve progresive dhe shkencore për proceset transformuese në Shqipëri. Kontributi i tij kryesor do të jetë për të reformuar debatin në vend me anë të sfidimit të hapësirës së politikave me të dhëna dhe analiza të cilat janë të bazuara në hulumtime shkencore. Kjo është e një rëndësie të madhe në kohën kur mediat dhe hapësira politike institucionale po mbizotërohen gjithnjë e më shumë nga retorika personalizuar, argumentimi i paqartë dhe pozicione të paqarta për çështje të rëndësishme politike.

Adresa: Bulevardi ‘Gjergj Fishta’ Pranë Ekspozitës, Kulla 2, Tirana 1000, Albania

www.issh.al info@issh.al @issh_al @institutiSSH instituti_issh

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë
domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Shteteve të Bashkuara.